

Nr. 731/ Prot.,
11

Tiranë më 06.08.2026

Lënda: Mbi trajtimin e kërkesës

Z. Franci NURI - Sekretar për të Drejtat e Njeriut

PARTIA DEMOKRATIKE

Ad: Bulevardi “Zhan d’Ark”, Nr. 11, Tiranë

Z. Nuri,

Avokati i Popullit është njohur me ankesën tuaj për ndikimin e projektit “SMART CITY” në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nr. 310 Prot., datë 22.07.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 731 Prot., datë 24.07.2026.

Duke ju falënderuar për ngritjen e këtij shqetësimi, vlerësojmë në mënyrë të veçantë faktin që Partia Demokratike i drejtohet Avokatit të Popullit si garanti i pavarur të të drejtave dhe lirive themelore. Në përgjigje të besimit tuaj tek legjitimiteti dhe tek pavarësia e Avokatit të Popullit për të hetuar këtë çështje, ju vë në dijeni sa më poshtë:

Në përmbushje të misionit kushtetues të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e parregullta të organeve të administratës publike, të sanksionuar në nenet 60–63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 2, 12, 13, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ju njoftoj se ankesa juaj është pranuar dhe kam vendosur nisjen e hetimit administrativ për shqetësimin e ngritur prej jush.

Objekt i hetimit do të jetë vlerësimi i përputhshmërisë së projektit “SMART CITY” me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së jetës private dhe të të dhënave personale, të garantuara nga nenet 35–37 të Kushtetutës, neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nga ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Çështja do të ndiqet nga një grup pune i përbërë nga tre ndihmëskomisionerë, nën drejtimin e Komisionerit të Seksionit për Policinë, Z. Besnik Deda.

Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes dhe interesin e lartë publik, institucioni do të vlerësojë edhe angazhimin e ekspertizës së pavarur të jashtme për vlerësimin e gjetjeve të grupit të punës, me qëllim garantimin e një analize të plotë, objektive dhe profesionale.

Në përfundim të hetimit administrativ, do të njoftoheni mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse të institucionit, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 8454/1999, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju sigurojmë se kjo çështje do të trajtohet me përgjegjshmëri të plotë institucionale dhe në zbatim rigoroz të legjislacionit në fuqi.

AVOKATI I POPULLIT

Endrit SHABANI

Endrit Shabani

